

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER ERMAL XH. HAMZAJ**



V2021053150059147029

DATE 17/03/2021
NR REP 1300



VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 17.03.2021, para meje Noter ERMAL XH. HAMZAJ, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Rruga: "Pashko Vasa", Pallati Nr.8, Shk.1, Zyra 5, Kt.2 Njesia Bashkiake Nr. 5, u paraqit personalisht:

DEKLARUES/IT:

Shoqëria CPM International, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e regjistrimit të bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NIUS L62030012K, me seli në adresë Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga Nikolla Tupe, Ndërtesa Nr.4, Shkalla Nr. 3, Apartamenti 16, përfaqësuar nga Administratori Dritan Leka, atësia Bujar, amësia Melita, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Grigor Heba N42; Njësia Administrative Nr. 5; 0000; Tiranë, lindur më 27/06/1986, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035466311 dhe nr. personal I60627019B.

DEKLARUES/IT:

Shoqëria DM & S, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e regjistrimit të bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NIUS K72322004L, me seli në adresë Njësia Bashkiake Nr.13, Rruga 'Kristo Luarasi', Pallati Pranë Kopshtit Botanik, Tek Tre Kullat, Kulla 1, Kati 1, Zk. 8270., përfaqësuar nga Administratori Voltisa Dervishi, atësia Petrit, amësia Bejaze, shtetase Shqiptare, lindur në Lushnjë dhe banues në Tiranë, me adresë Budi; Nd. .; Njësia Administrative Nr. 2; Tiranë 2; 0000; Tiranë, lindur më 19/07/1975, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 028676024 dhe nr. personal H55719109J.

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noterit AKT THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "Kapital-Parking" SHPK.

Unë Noteri, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenin 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER
ERMAL XH. HAMZAJ

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"Kapital-Parking" SHPK**

**KREU I
Dispozita te Pergjithshme**

Sot, në datën 17/03/2021 (dymijë e njetzet e nje) subjektet e mëposhteme:

- **Shoqeria "CPM International" SHPK**, shoqeri e se drejtes tregtare shqiptare, regjistruar ne QKB me date 30.08.2016, me NIPT L62030012K, me seli ne Tirane, Njesia Bashkiake Nr. 5, Rruga Nikolla Tupe, Nderresa 4, Shkalla 3, Apartamenti 16, perfaqesuar nga Administratori **Z. Dritan Leka**, atesia Bujar, amësia Melita, i datelindjes 27.06.1986, i lindur ne Tirane dhe banues në Tirane, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit nr. Personal I60627019B.
- **Shoqeria "DM&S" SHPK**, shoqeri e se drejtes tregtare shqiptare, regjistruar ne QKB me date 22.11.2007, me NIPT K72322004L, e ndodhur ne Tirane, Njesia Bashkiake Nr. 13, Rruga "Kristo Luarasi", pallati prane Kopshtit Botanik, tek tre Kullat, Kulla 1, kati 1, Zona Kadastrale 8270, perfaqesuar nga Administratori **Znj. Voltisa Dervishi**, e datelindjes 19.07.1975, lindur ne Lushnje dhe banuese ne Tirane, shtetase Shqiptare, madhore, me zotesi te plote per te vepruar, mbajtese e Leternjoftimit me Nr. Personal H55719109J. Ne cilesine e "Ortakeve Themelues", me vullnet te lire te plote e te sinqerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise, Kodin Civil ne fuqi, ligjin Nr. 9901 date 04.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare" dhe ligjin Nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit", vendosi te themeloje shoqerine tregtare, me pergjegjesi te kufizuar, me emertimin **"Kapital-Parking" SHPK**

**KREU II
Ortaket, Emri, Objekti, Kohëzgjatja dhe Zyra Qendrore**

Neni 1

Emri dhe Ortaket

- 1.1 Shoqeria eshte e organizuar dhe funksionon sipas formes "shoqeri me pergjegjesi te kufizuar" dhe mban emrin **"Kapital-Parking" SHPK**
- 1.2 Kapitali i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ndahet në një numër kuotash, në raport me kontributin e dhënë nga çdo ortak në shoqëri. Çdo ortak zotëron një kuotë të vetme në shoqëri.

Neni 2

Objekti

Shoqëria **"Kapital-Parking" SHPK** do te kete objekt veprimtarie:

Menaxhim i hapesires se parkimit dhe qendrave tregtare, Organizimi i eventeve, panairove, publikime publicitare, si dhe organizim tjeter artistik dhe televiziv te çdo forme. Perfaqesim ligjor ne keto organizime si dhe kryerjen e çdo procedure financiare e ligjore. Aktivitet ne fushen e interior-Architect e disigner te çdo lloji, mirembajtje dhe restaurim te objekteve te ndryshem. Konsulence financiare, ekonomike, juridike qe ka lidhje me biznesin, me aktivitetet te ndryshme tregtare te personave fizik dhe juridik perfshire institucione financiare dhe ato shteterore. Ndermjetesi ne lidhje me shitje te produkteve te ndryshme te percaktuara ligjerisht. Aktivitet ne fushen e pasurive te patundshme, vleresimin e pasurive te patundshme, te angazhohet ne shitjen me shumice dhe pakice te çdo lloj pasurie dhe te hap dyqane, dege apo zyra po te jete e nevojshme

per arritjen e qellimit te shoqerise. Manaxhim dhe administrim pronash dhe objektesh. Investime ne fushen e ndertimit dhe tregtimit brenda dhe jashte vendit te pasurive te pa luajtshme. Administrimin e bashkepronesise ne ndertesa. Per dhenien me qera, nen qera te ambjenteve te ndryshme

Neni 3

Kohëzgjatja

- 3.1 Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj per nje afat te pakufizuar, me perjashtim te rastit kur Asambleja e Ortakeve, sipas kuorumit perkates vendos ndryshe.
- 3.2 Shoqeria **"Kapital-Parking" SHPK** gezon statusin e personit juridik shqiptar nga momenti i regjistrimit si e tille ne regjistrin tregtar te QKB-se.

Neni 4

Zyra Qendrore

- 4.1 Zyra qendrore e shoqërisë ndodhet ne adresën: Tiranë, Njësia Bashkiake nr.13, Rruga " Kristo Luarasi", pallati pranë kopshtit Botanik, tek tre Kullat, kulla 1, kati 1, zk. 8270
- 4.2 Gjate veprimtarise se saj, shoqeria ka te drejte te krijojë dhe hape dege, filiale dhe/ose zyra perfaqesimi edhe ne qytete te tjera, brenda dhe/ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise, ne perputhje me legjislacionin e kerkuar ne fuqi sipas juridiksionit te vendit perkates.

KREU III

Neni 5

Vlera dhe pagesat e kapitalit te regjistruar

- 5.1 Kapitali i regjistruar i shoqerise është **100.000 Lek** (njqindmije lek), i barabarte me 1 (nje) kuote. Kontributet e ortakeve perbejne kapitalin e regjistruar te shoqerise.
- 5.2 Pjesëmarrja e Ortakeve në kapitalin e shoqërisë eshte ne raport me kontributin e derdhur prej tyre dhe vlera nominale e kuotes te seicilit ortak, llogaritet ne raport me seicilin kontribut, e paraqitur ne menyre te permbledhur sipas grafikut te meposhtem:

Nr.	Emri i Ortakeve	Kuota	Kontributi i ortakeve ne kapital (leke)	Perqindja ne kapital
1.	Shoqeria "CPM International" Shpk	1	50.000	50 %
2.	Shoqeria "DM&S" Shpk	1	50.000	50 %
Totali		2	100.000	100 %

- 5.3 Kontributet sa me siper jane nenshkruar dhe shlyer plotesisht nga ana e ortakeve te shoqerise.

Neni 6

Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

- 6.1 Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kualifikuar (tre të katërtat) të votave të ortakëve në përputhje me parashikimet e nenit 87 të Ligjit.

6.2 Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar te shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar të votave (tre të katërtat) në përputhje me parashikimet e nenit 87 të Ligjit, duke pasur parasysh që te respektohet minimumi i parashikuar nga Ligji për Shoqëritë Tregtare.

KREU IV

Neni 7

Kuotat dhe Kalimi i Kuotave

- 7.1 Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim ndermjet paleve.
- 7.2 Transferimi i kuotave te ortakeve te shoqërisë brenda ortakerisë apo ne drejtim te personave te trete jashte ortakerisë eshte i kushtezuar ne cdo rast nga ushtrimi i te drejtes se parablerjes ne favor te ortakeve ekzistues.

Ortaku, para se t'i transferoje ne cdo forme kuotat e veta nje ortaku ekzistues brenda shoqërisë apo nje personi te trete jashte saj, detyrohet të njoftojë me shkrim paraprakisht te gjithë ortaket ekzistues nëse dëshirojnë të blejnë kuotat me të njëjtat kushte ekonomike si dhe ne menyre perpjestimore sipas kuotave qe zoterojne ne kapital te shoqërisë.

Në rast se te gjithë ortaket nuk përgjigjen me shkrim brenda 20 diteve nga njoftimi apo deklarojne se nuk dëshirojnë të blejnë kuotat, ortaku është i lirë të transferoj kuotat e tij teresisht apo pjeserisht në drejtim te personave te trete jashte ortakerisë.

Në rast se nje pjese e ortakeve ekzistues pergjigjen me shkrim brenda 20 diteve dhe deklarojne se dëshirojnë të blejnë kuotat, ortaku është i detyruar ti transferoj kuotat e tij në drejtim te tyre ne menyre te barabarte (dmth ne rast se dy ortak shprehin deshiren per blerjen e kuotave, ato do tu shiten te dy ortakeve ne menyre te barabarte, pra 50% seicilit).

Neni 8

Kalimi i kuotave me Trashëgimi ose si pasojë e Falimentimit

- 8.1 Nëse një ortak vdes, trashëgimtari ose trashëgimtarët në rastin e bashkëzotërimit të kuotave, dhe trashëgimtarët e tij në rast se ky person ishte zotërues ose trashëgimtar i vetëm i bashkëzotëruesve të kuotave, do të jenë personat e vetëm të njohur nga shoqëria si gëzues së të drejtave mbi kuotën e tij; pavarësisht parashikimeve të këtij Statuti, pasuria e ortakut të vdekur nuk çlirohet nga përgjegjësia në lidhje me kuotën e zotëruar nga ai vetëm apo së bashku me persona të tjerë.
- 8.2 Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku, pas paraqitjes së provave të kërkuara nga Administratori, mund të zgjedhë të bëhet zotërues i kuotës ose të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër te caktuar prej tij si përfitues të kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotërues i kuotës, ai njofton shoqërinë në lidhje me këtë zgjedhje. Nëse ky person zgjedh që një person tjetër të regjistrohet si zotërues i kuotës, ai kalon kuotën në dobi të personit tjetër.
- 8.3 Personi që fiton të drejta mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku do të ketë të drejtat që gëzonte zotëruesi i kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, deri në momentin e regjistrimit ne QKB.

Kreu IV Asambleja e Përgjithshme

Neni 9

Kompetencat dhe Thirrja e Asamblese se Përgjithshme

- 9.1** Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimarrës i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme do të vendosë, por pa u kufizuar, për çështjet e mëposhtme të Shoqërisë:
- a. përcaktimi i politikave tregtare;
 - b. ndryshime të Statutit;
 - c. emerimi dhe shkarkimi i administratorit/administratoreve;
 - d. emerimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe i eksperteve kontabel të autorizuar;
 - e. miratimi i skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat c. dhe d.;
 - f. mbikeqyrja e zbatimit të politikave tregtare nga ana e administratorit/administratoreve, duke përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve mbi ecurinë e aktivitetit të Shoqërisë;
 - g. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve mbi ecurinë e aktivitetit të Shoqërisë;
 - h. zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;
 - i. pjesëtimi i kuotave dhe anulimi i tyre;
 - j. përfaqësimin e shoqërisë në gjykime dhe në procedime të tjera kundër administratorit/administratoreve të saj;
 - l. riorganizimi dhe prishja e Shoqërisë;
 - m. miratimi i rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
 - n. çështje të tjera të parashikuara nga Ligji për Shoqëritë Tregtare dhe Statuti.

Nëse shoqëria mbetet me një ortak, atëherë ortaku i vetëm detyrohet ta regjistrojë këtë fakt, sipas nenit 43, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", të ndryshuar. Nëse ortaku i mbetur nuk përmbush këtë detyrim, atëherë ortaku përgjigjet personalisht për detyrimet që shoqëria merr përsipër nga data në të cilën duhet të ishte kryer regjistrimi, sipas këtij neni, deri në datën në të cilën ky regjistrim u krye efektivisht."

- 9.2** Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e përmendura në pikat (g) dhe (h) me siper pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes së asamblese së përgjithshme.
- 9.3** Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nga administratori apo ortakët e minorancës sipas dispozitave të ligjit për shoqëritë tregtare në fuqi nëpërmjet një njoftimi me shkresë, me postë ose e-mail drejtuar çdo ortaku, përfshirë edhe përfaqësuesin e kuotave në zotërim të përbashkët. Njoftimi duhet të kryhet të paktën 7 (shtatë) ditë të plota përpara datës së caktuar për mbledhjen përveç rasteve kur njoftimi i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme i cili përmban një afat më të shkurtër është miratuar nga të gjithë ortakët që zoterojnë 100% të kapitalit të shoqërisë.
- 9.4** Njoftimi për thirrjen e Asamblese duhet të përmbajë në mënyrë të qartë datën, ditën, kohën, vendin dhe rendin e ditës të mbledhjes, së bashku me dokumentacionin përkatës dhe do t'u dërgohen të gjithë Ortakëve të Shoqërisë të paktën 7 (shtatë) ditë përpara mbledhjes.

Ne rast ndryshimi te rendit te dites, do te ndiqet e njejta procedure njoftimi qe pershkruhet me siper.

Neni 10

Kuorumi i nevojshem

- 10.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë jo me pak se 31 për qind të kapitalit të shoqërisë.
- 10.2 Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë jo me pak se 51 për qind të kapitalit të shoqërisë.
- 10.3 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

- 11.1 Asambleja e Ortakeve vendos me 3/4 të ortakëve zoterues te kapitalit te shoqërisë me te drejte vote, për çështje te rendesishme qe kane te bejne me ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë etj.
- 11.2 Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e thjeshte te votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera te zakonshme si :
- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërblimeve;
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- 11.3 Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
Autorizimi jepet në formë shkresore vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme dhe është i vlefshëm edhe për mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
- 11.4 Kryetari i mbledhjes se asamblese se pergjithshme do te jete administratori i shoqërisë i cili do te drejtoje mbledhjen dhe asambleja e pergjithshme ne cdo mbledhje te saj do te emeroje me shumice te thjeshte te votave te ortakeve pjesemarres edhe nje person tjetër për të mbajtur proces-verbalin e mbledhjes se asamblese se pergjithshme.
- 11.5 Çdo vendim i mbledhjes se asamblese se pergjithshme do te regjistrohet ne proces-verbal, i cili do te mbahet ne perputhje me nenin 90 te ligjit Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare.

5



Neni 12

Votat e Ortakëve

12.1 Cdo ortak ka të drejta vote në përpjesëtim me vlerën nominale të kuotës së tij. Bashkëzotëruesit e një kuote ushtrojnë të drejtat e votës bashkërisht, sipas nenit 72 të ligjit për shoqëritë tregtare në fuqi.

12.2 Asnjë ortak nuk do të votojë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve, në lidhje me kuotën e zotëruar prej tij, nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet që kanë të bëjnë me këtë kuotë.

Kreu V

Administratori

Neni 13

Emërimi i Administratorit

13.1 Asambleja e Përgjithshme zgjedh një ose më shumë persona fizikë si Administratorë të shoqërisë për një periudhë pesëvjeçare, në pajtim me parashikimet e shkronjës "c" të pikës 1 të nenit 81 dhe nenit 95 të Ligjit. Emërimet do të jenë individuale dhe sipas një vendimi të marrë me shumicën e votave të ortakeve në Asambleja e Përgjithshme, i cili, nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si Administrator.

13.2 Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i shoqërisë "**Kapital-Parking**"

Shpk:

Z. Alban HYSAJ, i datelindjes 24.01.1996, lindur dhe banues në Tiranë, shtetas Shqiptar, madhor, me zotësi të plote për të vepruar, mbajtes i Letërnjoftimit me Nr. Personal J60124047P per nje afat 5 vjecar, nga momenti i regjistrimit te ketij fakti prane Qendres Kombetare te Biznesit.

Neni 14

Kompetencat e Administratorit

14.1 Politikat tregtare të shoqërisë si dhe aktiviteti normal i saj do të administrohen nga Administratori i cili mund të ushtrojë të gjithë kompetencat që nuk i rezervohen Asamblesë së Përgjithshme sa me sipër dhe ligjit tregtar në fuqi.

14.2 Pa u kufizuar sa me sipër, në mënyrë të vecantë, Administratori ka keto kompetenca:

- (i) do të drejtojë dhe të përfaqësojë Shoqërinë përseja i përket administrimit të zakonshëm;
- (ii) do të nënshkruajë cdo marrëveshje në emër të Shoqërisë;
- (iii) do të hapë llogari në emër të Shoqërisë me cdo bankë që kryen aktivitet në Shqipëri ose jashtë saj,
- (iv) do të përgatitë të gjitha planet për marrjen e financimeve, do të nënshkruajë cdo kontratë huaje apo kontratë tjetër që parashikon një borxh apo borxh të mundshëm për Shoqërinë, hipotekë, peng apo cdo marrëveshje tjetër që krijon apo mund të krijojë një barri mbi pasuritë e Shoqërisë, marrëveshje garancie, kontratë për shitjen e pasurive të paluajtshme apo të luajtshme të Shoqërisë. Të gjitha veprimet e parashikuara këtu (pika iv) do të jenë të vlefshme nëse janë të autorizuar shprehimisht me anë të një Vendimi të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicë unanime;
- (v) do të urdherojë dhe kryejë pagesa në emër të Shoqërisë – duke nënshkruar dokumentet / instrumentet e pagesave;

- 
- (vi) do të kujdeset për mbajtjen e sakte e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabel të Shoqërisë;
 - (vii) do të përgatise dhe nënshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, ia paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme;
 - (viii) do të krijojë një sistem monitorimi dhe paralajmërimi njoftimi të hershëm për rrethanat që kërcenojnë ekzistencën e Shoqërisë;
 - (ix) do të kryejë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të Shoqërisë, sipas kërkesave të Ligjit nr. 9723, datë 3 Maj 2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit";
 - (x) do t'i raportojë Asamblesë së Përgjithshme për zbatimin e politikave tregtare dhe për realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë;
 - (xii) do të marrë në punë, emerojë, shkarkojë të punësuar të Shoqërisë për çdo nivel, përfshirë edhe të punësuar me kohë të pjesshme, konsulentë, agjente, do të përcaktojë kompetencat dhe detyrat e tyre, si dhe do të përcaktojë shpërblimin e tyre;
 - (xi) të kryejë detyra të tjera, të përcaktuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare, duke pasur parasysh respektimin në çdo rast të kufizimeve të parashikuara nga ky Statut, si dhe detyrat e dhëna me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Asambleja e përgjithshme, në bazë të një vendimi të marrë me shumicën e përcaktuar sa më sipër, ka të drejtë të ngrejë padi përpara gjykatës kompetente për shfuqizimin e vendimeve të administratorëve, si pasojë e shkeljes së rëndë të ligjit ose të statutit dhe/ose padi të tjera që parashikon ky ligj ose statuti ndaj administratorëve apo ortakëve.

Neni 15

Skualifikimi dhe Shkarkimi i Administratorit

Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

1. personi nuk është më Administrator sipas parashikimeve të Ligjit përfshirë edhe parashikimet e pikës 6 të nenit 95 të Ligjit;
2. personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
3. ndodhet ose mund të ndodhet në kushtet e pa-afetësisë fizike;
4. jep dorëheqje nga detyra duke njoftuar shoqërinë;
5. vdekjeje;
6. ndodhet në situata apo rrethana të cilat e bëjnë të pamundur ushtrimin e detyrave të tij;

Neni 16

Kufizimet në Veprimet e Administratorit

- 16.1 Administratori nuk do të lidh marrëveshje për çështje në të cilin ai ka, direkt ose indirekt, një interes apo detyrim i cili është material, që është apo mund të jetë në kundërshtim me interesat e shoqërisë, në pajtim me nenin 13 të Ligjit për shoqëritë tregtare, deri në momentin kur Asambleja e Përgjithshme e shoqërie, në bazë të kuorumit të kërkuar, autorizo lidhjen e kësaj marrëveshje.
- 16.2 Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm për një çështje të caktuar. Autorizimi i përgjithshëm duhet të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.



7

Kreu VI
Prishja dhe njoftimet

Neni 17

17.1 Shkaqet e prishjes së shoqërisë

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar priset:

- a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
 - b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
 - c) në rast se objekti bëhet i parealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
 - ç) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 të ligjit për shoqëritë tregtare;
 - d) në raste të tjera, të parashikuara në statut;
 - dh) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
 - e) për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.
- 17.2** Në rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e marrë me shumicën e kualifikuar së votave të Asamblesë së Përgjithshme, mund të shpërndajë në dobi të ortakëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis ortakëve të shoqërisë.
- 17.3** Administratori është i detyruar të regjistrojë prishjen e Shoqërisë në QKB, me përjashtim të rastit kur prishja bëhet me vendim gjykate; në këtë rast është gjykata që i dërgon njoftimin QKB-se.

Neni 18

Njoftimet

- 18.1** Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jenë me shkrim ose (nëse zbatohet) nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e parashikuar sipas pikës 3 të nenit 4 të këtij Statuti dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin.
- 18.2** Shoqëria mund të njoftojë një ortak personalisht ose duke e dërguar njoftimin me letër porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të ortakut ose në adresën apo postën elektronike (nëse ka) që i është njoftuar shoqërisë nga ortaku. Kur ka disa bashkëzotërues të një kuote, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të tyre të përbashkët në përputhje me pikën 2 të nenin 72 të Ligjit.

Neni 19

Te Ndryshme



- 19.1 Cdo dokument qe leshohet per dhe ne emer te shoqerise eshte i pavlefshem nese nuk mban vulen e saj.
- 19.2 Te gjitha marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen me Kodin e Punes dhe cdo akt tjeter ligjor dhe nenligjor te zbatueshem te Republikes se Shqiperise, ne fuqi dhe ne veprim kohe pas kohe gjate periudhes se ushtrimit te aktivitetit te saj tregtar.
- 19.3 Viti financiar zgjat 12 (dymbedhjete) muaj, duke filluar me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti.
- 19.4 Ne fund te cdo viti financiar, Administratori harton bilancin vjetor dhe raportin e administrimit, te cilet i dergohen per miratin Asamblese se zakonshme.
- 19.5 Per te gjitha ceshjet qe nuk jane parashikuar ne kete Statut, do te zbatohen parashikimet e Ligjit per Shoqerite Tregtare ne fuqi, te azhornuar.

NENI 20

Dispozita perfundimtare

- 20.1 Ky statut perben dokumentin e vetem te shoqerise qe parashikon themelimin dhe organizimin e veprimtarise se shoqerise. Ky Statut mund te ndryshohet, rishikohet dhe/ose shfuqizohet pjeserisht ose teresisht dhe te zevendesohet me nje statut te ri vetem me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve sipas shumices se cilesuar te percaktuar me siper.
- 20.2 Per sa nuk eshte parashikuar ne kete statut, ortaket do ti referohen legjislacionit tregtar Shqiptar ne fuqi si dhe praktikave tregtare ne vend.

Ky statut u redaktua ne 4 ekzemplare, me permbajtje dhe vlere te njejte juridike, ne gjuhen Shqip dhe u nenshkrua nga ortaket themelues pa asnje rezerve.


ORTAKET THEMELUES

Shoqeria "CPM International" SHPK
Perfaqesuar nga:

Dr. Idris...


Jonik...

Shoqeria "DM&S" SHPK
Perfaqesuar nga:

Idris...




NOTER
ERMAL XH. HAMZAJ
